

20210771167

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË BANKËS SË MAQEDONISË PËR PËRKRAHJEN E ZHVILLIMIT

Neni 1

Në Ligjin e Bankës së Maqedonisë për Përkrahjen e Zhvillimit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 105/2009), në titullin e ligjit fjalët: “Banka e Maqedonisë për Përkrahjen e Zhvillimit” zëvendësohen me fjalët: “Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 2

Në nenin 1 fjalët: “Banka e Maqedonisë për Përkrahjen e Zhvillimit” zëvendësohen me fjalët: “Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 3

Në nenin 2, fjalët: “Banka e Maqedonisë për Përkrahjen e Zhvillimit (në tekstin e mëtejme: BMPZH)” zëvendësohen me fjalët: “Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut” (në tekstin e mëtejme: BZHMV”).

Neni 4

Në nenin 9, pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2) siç vijon:

„(BZHMV) fiton pronën e patundshme dhe të tundshme dhe atë e shfrytëzon, menaxhon dhe disponon pa kufizime.”

Paragrafi (2) bëhet paragraf (3).

Neni 5

(1) Neni 13 ndryshon dhe bëhet:

„Për realizimin e projekteve dhe/ose programeve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, BZHMV:

- 1) miraton kredi;
- 2) miraton kredi me shkallë të subvencionuar të kamatës dhe
- 3) jep garanci nga Fondi Garantues.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe BZHMV lidhim marrëveshje me të cilën do të përcaktohen kushtet me të cilat lejohen kreditë sipas paragrafit (1) pikat 1) dhe 2) të këtij neni, shuma e mjeteve dhe mënyra e sigurimit dhe bartjes së tyre në BZHMV.

(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe BZHMV-ja lidhin marrëveshje me të cilin do të përcaktohen kushtet me të cilat jepen garancitë sipas paragrafit (1) pika 3) të këtij neni.

Neni 6

Pas nenit 13 shtohen shtatë nene të reja: 13-a, 13-b, 13-v, 13-g, 13-d, 13-gj dhe 13-e siç vijojnë:

„Neni 13-a

BZHMV, me pajtimin e marrë paraprakisht nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të formojë fonde me mjete për mbështetjen e zhvillimit të ekonomisë maqedonase për të cilët në BZHMV-ja organizohen njësi të posaçme organizative.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe BZHMV-ja lidhin marrëveshje në të cilat do të përcaktohet mënyra e punës dhe dedikimi i fondeve sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Neni 13-b

Për mbështetjen e zhvillimit nëpërmjet garantimit të kredive për mjete kapitale dhe të kredive për mjete themelore të miratuara nga ana e bankave dhe bankave kursimore të cilat nga guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut kanë marrë leje për themelimin dhe punën, në BZHMV organizohet Fond i Garantuar si njësi e posaçme organizative.

Neni 13-v

(1) Mjetet e Fondit Garantues sigurohen nga:

Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, si mjete pa kthim në shumë prej 10 milionë euro;

2) huat dhe/ose linjat kreditore nga institucionet ndërkombëtare financiare;

3) donacioni nga vendi dhe nga jashtë;

4) të ardhura nga provizionet për garancitë e dhëna dhe

5) të ardhura nga plasimi në letra me vlerë.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të miratojë vendim për rritjen e shumës së mjeteve pa kthim sipas paragrafit (1) pika (1) të këtij neni.

(3) BZHR-ja për Ministrinë e Financave deri më 30 qershor në vitin rrjedhës dorëzon raport për shumën e garancive të paguara dhe gjendjen e mjeteve pa kthim të siguruar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut sipas paragrafit (1) pika (1) të këtij neni, me gjendjen më 31 maj në vitin rrjedhës.

(4) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të miratojë vendim për rimbushjen e mjeteve të pa kthim me mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të Ministrisë së Financave pas raportit të marrë sipas paragrafit (3) të këtij neni, më së voni deri më 31 mars në vitin rrjedhës.

(5) Për mjetet sipas paragrafit (1) të këtij neni Fondi Garantues nuk llogarit dhe nuk arkëton kamatë.

(6) Mjetet e Fondit Garantues nuk hyjnë në kapitalin e BZHMV-së dhe mund të shfrytëzohen vetëm për dedikimet e përcaktuara në nenin 13-g të këtij ligji.

(7) Për punën me mjetet e Fondit Garantues, BZHMV hap llogari dedikuese të posaçme në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(8) Për mjetet e Fondit Garantues, BZHMB mban evidencë financiare të kontabilitetit.

(9) Mjetet e Fondit Garantues mund të plasohen në letra me vlerë afatshkurtra të dhëna nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(10) Të ardhurat nga kamata nga plasimet sipas paragrafit (9) të këtij neni paguhen në llogari të paragrafit (7) të këtij neni dhe janë pjesë përbërëse e mjeteve të pakthyeshme të siguruar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 13-g

(1) Mjetet e Fondit Garantues shfrytëzohen për dhënien e garancive për sigurimin e pagesave në bazë të kryegjësë së kredive të reja të lejuara për mjete kapitale dhe për mjete themelore me afat të maturimit deri tetë vjet me dinamikë të paraparë që më parë, të lejuara nga ana e bankave dhe bankave të kursimit të cilat kanë leje për themelimin dhe punën e dhënë nga guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Shfrytëzuesit e garancive mund të jenë tregtarë mikro, të vegjël dhe të mesëm, si dhe tregtarë të mëdhenj të cilët kryejnë eksport të regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(3) Tregtarë të mëdhenj të cilët kryejnë eksport në kuptim të këtij ligji janë shoqëri tregtare të cilët shpenzimet në bazë të eksportit kanë pjesëmarrje prej së paku 30 % nga të hyrat e përgjithshme të realizuara në vitin fiskal e cila edhe të hyra të vitit në të cilën është miratuar garancia.

- (4) Garancitë sipas paragrafit (1) të këtij neni miratohen për projekte të cilat:
- 1) janë financiar me mjete të BZHMV-së;
 - 2) e ndotin ambientin jetësor dhe natyrën;
 - 3) janë dedikuar për prodhim dhe distribuim të armëve dhe pajisjeve ushtarake;
 - 4) janë dedikuar për prodhimin e duhanit, drogave dhe mjeteve tjera narkotike;
 - 5) janë të lidhura me lojërat e fatit;
 - 6) përfshijnë eksperimente mbi kafshët e gjalla;
 - 7) janë të lidhura me tregti të patundshmërive;
 - 8) janë të lidhura me aktivitetet financiare dhe
 - 9) i realizojnë shoqëritë tregtare në pronësi shtetërore ose shoqëri tregtare në të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut është partner ose aksionar me së paku 51% nga kryegjëja bazë.

Neni 13-d

Fondi Garantues garanton deri 80% të kredive nga mjetet qarkulluese edhe deri 50% e kredive për mjete bazë.

Neni 13-gj

1) Për garanci të miratuara të shfrytëzuesve të garancive sipas nenit 13-g paragrafi (2) të këtij ligji zbatohen:

- Portofolio garanci dhe/ose
- 2) garanci individuale.

(2) Portofolio garanci në kuptim të këtij ligji janë garanci të portofolios së kredive të caktuara nga bankat ose bankat e kursimit të cilët jepen në bazë të marrëveshjes së lidhur ndërmjet BZHMV-së dhe bankës ose bankës së kursimit.

(3) Garanci individuale në kuptim të këtij ligji është garanci për kredi të miratuar nga ana e bankës ose bankës së kursimit të tregtarit të madh i cili kryen eksport sipas neni 13-g paragrafi (3) të këtij ligji.

(4) Mënyra e dhënies së garancive ndërmjet BZHMV dhe bankës ose bankës së kursimit rregullohet me marrëveshje në pajtim me Ligjin e Marrëdhënies së Detyrueshme.

Neni 13-e

(1) Garancitë sipas nenit 13-g të këtij ligji miratohen në dobi të bankës dhe bankave të kursimit të cilat guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ka marrë leje për themelim dhe punë.

(2) Shuma e përgjithshme e kredive të miratuara me garanci nga Fondi Garantues nuk mund ta tejkalojë dhjetëfishin e shumës së mjeteve të Fondit Garantues.

(3) Ekspozimi kundrejt tregtarit të njëjtë dhe me të persona të lidhur në bazë të garancisë nga Fondi Garantues rregullohet në marrëveshje sipas nenit 13 paragrafi (3) të këtij ligji.

(4) Ekspozimi kundrejt bankës së veçantë në bazë të portofolio garancisë nga Fondi Garantues mund të jetë më së shumti deri 25 % nga shuma e mjeteve të Fondit Garantues.

(5) Ekspozimi kundrejt bankës së kursimit të veçantë në bazë të portofolio garancive nga Fondi Garantues mund të jetë më së shumti deri 10% nga shuma e mjeteve të Fondit Garantues.

(6) Ekspozimi kundrejt bankës së veçantë ose bankës së kursimit në bazë të garancive nga Fondi Garantues nuk llogaritet në ekspozim sipas nenit 14 të këtij ligji.

(7) Bankat dhe bankat e kursimit mund të parashtrajnë kërkesë te BZHMV-ja për aktivimin e garancisë nëse shfrytëzuesi i kredisë vonon së paku 60 ditë me pagesën e kredisë në bazë të borxhit kryesor me garanci të dhënë nga Fondi Garantues.

(8) Garancitë e dhëna nga Fondi Garantues paguhet në afat prej 30 ditëve nga dorëzimi i kërkesës te BZHMV-ja për pagesën e garancive.

(9) BZHMV ka të drejtë nga mjetet e Fondit Garantues të arkëtojë provizione dhe shpenzime të tjera të cilët dalin nga puna e Fondit Garantues në lartësi e rregulluar në marrëveshjen sipas nenit 13 paragrafi (3) të këtij ligji.

(10) BZHMV ka obligim të ndër marrë masa të lidhura me arkëtimin e kërkesave në bazë të garancive të dhëna.“

Neni 7

Në nenin 14 paragrafi (5) ndryshon dhe bëhet:

„(5) Këshilli mbikëqyrës i BZHMV-së lejon ekspozim kundrejt bankës së veçantë prej mbi 20 % nga mjetet personale të BZHMV-së.”

Neni 8

Pas nenit 18 shtohet nen i ri 18-a siç vijon:

„Neni 18-a

(1) BZHMV-ja më së voni deri 30 qershor në vitin rrjedhës dorëzon për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut raport vjetor për punën e Fondit Garantues për vitin paraprak dhe të fondeve të organizuara në pajtim me nenin 13-a paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) BZHMV shpall shumë të kredive të miratuara, numër të kredive të miratuara, shuma e garancive të miratuara dhe limite të garancive për banka dhe banka të kursimit të dhëna nga Fondit Garantues në ueb faqen e vet të bazë tre mujore.

(3) BZHMV për Ministrinë e Financave dorëzon raport gjysmë vjetor për strukturën e kredive të miratuara me garanci nga Fondi Garantues për kategori të rrezikut me gjendje 30 qershor dhe dhjetor më së voni 30 ditë pas kalimit të gjysmëvjetorit.

(4) Ministria e Financave, në bazë të të dhënave të dorëzuara nga BZHMV sipas paragrafit (3) të këtij neni në ueb faqen e vet shpall raport gjysmëvjetor për rreziqe fiskale të Fondit Garantues, ekspozim të garantuar dhe procedura të filluara për aktivimin e garancive.”

Neni 9

Në gjithë tekstin e ligjit fjalët: “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 10

Në tërë tekstin e ligjit shkurtesa "BMMZH" zëvendësohet me shkurtesën “BZHMV”.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.